



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 830/11 prot.

Tiranë, më 25.11.2019

VENDIM

Nr. 86, datë 25.11.2019

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT PËR SHORTIN E VEÇANTË DHE TË POSAÇËM SIPAS PIKËS 8 TË NENIT 3 TË RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË SHORTIT NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mbështetje të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores së veprimtarisë së Komisionit, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.7.2017, si dhe të pikës 8 dhe 9 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” miratuar me vendimin nr. 50, datë 18.10.2019, në mbledhjen e datës 25.11.2019,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së subjekteve të rivlerësimit për shortin e veçantë dhe të posaçëm sipas pikës 8 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Zhvillimin e shortit ditën e mërkurë, datë 11 dhjetor 2019, ora 16:00, në sallën e mbledhjeve të godinës së Komisionit.
3. Njoftimin për pjesëmarrje të vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
4. Publikimin e kësaj liste në faqen zyrtare të institucionit pas hedhjes së shortit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Genta Tafa (Bungo)

